

URDHËR
Nr.931, datë 28.12.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar,

URDHËROJ:

Organizatorët e lojërave të fatit, për garantimin e fituesit/fituesve të lojërave të fatit, duhet të ngurtësojnë, në një llogari të veçantë bankare, një shumë të caktuar si më poshtë vijon:

1. Për lojërat aritmetike

a) Për bingo, fondi i ngurtësimit për shoqërinë të përcaktohet sipas kategorizimit të qyteteve:

- Për qytetet e kategorisë së I (Tiranë dhe Durrës), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 2.000.000 (dy milionë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së II (Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat dhe Kavajë), fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

- Për qytetet e kategorisë së III (të gjitha qytetet e tjera), fondi i ngurtësimit të jetë në masën, 1.000.000 (një milion) lekë.

- Për çdo filial dhe sallë të hapur në territorin e Republikës së Shqipërisë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën:1.000.000 (një milion) lekë

b) Për lojërat aritmetike, që zhvillohen për pjesëmarrës jashtë sallave, fondi i ngurtësimit të jetë në masën: 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

2. Për lojërat e fatit sportive

a) Kategoria "Basti", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 20.000.000 (njëzet milionë) lekë.

b) Kategoria "Konkurs për parashikimet sportive", fondi i ngurtësimit të jetë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

3. Për lotaritë

a) Lotari me shorte, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

b) Lotari të çastit, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 5.000.000 (pesë milionë) lekë për çdo lotari (leje) të organizuar. Ky fond do të çngurtësohet vetëm pas përfundimit të çdo lotarie (loje).

4. Lojërat elektronike, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike, por jo më shumë se 5.000.000 (pesë milionë) lekë.

Shoqëritë e licencuara të lojërave të fatit janë të detyruara të plotësojnë fondin e ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve të lojërave të fatit brenda datës 31.1.2007.

Mospagimi i kësaj shume brenda datës 31.1.2007, përbën shkak ligjor për heqjen e lejes së veprimtarisë për këto shoqëri.

Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Licencave dhe e Menaxhimit të Kontratave, Sektori i Lojërave të Fatit.

Çdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli**